

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

P.l.n.346/2015

NE EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm me gjyqlarin e vetëm gjykuar Mentor Hajraj dhe me procesmbajtësen Albana Gasim, në linden penale ndaj të akuzuarit [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] komuna e Mitrovicës, për shkak të veprës penale Vjedhje e rëndë nga nen 327 paragrafi 1 pika 1.1 të KPRK-së lidhur me nenin 81 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.318/2015, të dt.25.09.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me dt.25.05.2018, i cili ishte i hapur për publikun, në të cilin kanë prezantuar prokurori i shtetit Jovo Radoviq, i akuzuari [REDAKTUAR] dhe përkthyesi i gjykatës Shaban Hajra, me dt.28.05.2018, publikisht e ka shpallur, ndërsa me dt. 29.05.2018, e përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari [REDAKTUAR] nga i ati [REDAKTUAR] dhe nena [REDAKTUAR] e vajzërisë [REDAKTUAR] i lindur me dt. [REDAKTUAR] në fshatin [REDAKTUAR] komuna e Mitrovicës, tani me vendbanim në Mitrovicë në Rr. " [REDAKTUAR] ", shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa punë, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr. personal [REDAKTUAR]

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: 1.Me dt.09.03.2014 rreth orës 11:56 minuta në fshatin Rashan komuna e Mitrovicës, me qëllim me marrjen e sendeve të huaja të luajtshme vetit t'i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm nga shtëpia e të dëmtuarit [REDAKTUAR] ka marrë një televizor " Panasonic", një kablo elektrike 15 metra, dy printerë të vjetër, një makinë shkrimi e tipit të vjetër, një centrifug për bletë, në atë mënyrë që përmes gilinderave të katit të parë të shtëpisë së të dëmtuarit [REDAKTUAR] ka depërtuar në ballkonin e katit të dytë duke përdorur forcën- duke shtyrë derën e ballkonit ka hyrë brenda në shtëpi dhe i ka marrë sendet e lartcekura.

2. Me datën dhe kohën e cekur si në pikën 1 të dispozitivit , i akuzuari [REDAKTUAR] me qëllim me marrjen e sendeve të huaja të luajtshme vetit t'i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm nga oborri i shtëpisë së të dëmtuarit [REDAKTUAR] me forcë ka thyer shtyllat e metalta, ka hjekur telin dhe ka depërtuar në oborrin e

shtëpisë ku edhe ka marr tri bletë të cilat ishin të vendosura para ballkonit të shtëpisë.

- Me këtë ka kryer veprën penale - Vjedhje e rëndë në vazhdim nga neni 327 parag.1 pika 1.1 të KPRK-së, lidhur me nenin 81 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të kësaj dispozite ligjore dhe në bazë nenave 41, 45, 46, 73, 75, 76 dhe 81 të KPRK-së e lidhur me nenet 450 parag.1 dhe 2 nënparag. 2.6, 453 parag.1, 463 parag.1 dhe 2 dhe nenit 365 të KPP-së e;

GJYKON

Të akuzuarin [REDAKTUAR] me dënim me gjobe në shume prej 300 euro dhe dënimi me burg në kohëzgjatje prej një (1) vit e gjashtë (6) muajsh.

Dënimin me burgim ndaj të akuzuarit do të ekzekutohet pasi aktgjykimi të marr formën e prerë, ndërsa dënimin e shqiptuara me gjobe i akuzuari obligohet ta paguajnë në afatin prej 30 ditësh pasi aktgjykimi të marr formën e prerë. Nëse i akuzuari nuk e paguaj dënimin me gjobe në afatin e caktuar nga gjykata atëherë dënimi me gjobe do t'i zëvendësohet në dënim me burgim sipas nenit 46 parag.3 të KPRK-se.

Palët e dëmtuara [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], udhëzohen nga gjykata që kërkesën pasurore juridike ta realizojnë në kontest të rregullt civil.

Obligohet akuzuari [REDAKTUAR] që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajnë shumën prej 30 euro, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor obligohet të paguaj shumën prej 10 euro, të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh, prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Arsyetimi

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën e saj PP.II.nr.318/2015, të dt.25.09.2015, i ka akuzuar të akuzuarin [REDAKTUAR] për kryerjen e dy veprave penale - Vjedhje e rënde nga neni 327 parag.1 pika 1.1 të KPRK-së, ndërsa të akuzuarit [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] i ka akuzuar për kryerjen e veprës penale Vjedhje e rënde nga neni 327 parag.1 pika 1.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, po ashtu me këtë aktakuzë është akuzuar edhe i akuzuari [REDAKTUAR] për kryerjen e veprës penale Blerja, pranimit ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 parag.1 të KPRK-së.

Gjykata në këtë çështje penale ka mbajtur shqyrtimin fillestar me dt. 25.05.2018, në të cilin kanë prezantuar prokurori i shteti Jovo Radović, të akuzuarit [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] kanë prezantuar edhe mbrojtësit e të akuzuarit Afrim Hyseni, av. Gazmend Ismajli dhe Elvir Imeri

dhe mbrojtësi i të akuzuarit Kemal Musa, av. Gani Rexha, në këtë shqyrtim fillestar ka qenë edhe përkthyesi i gjykatës Shaban Hajra.

Në shqyrtim fillestar gjykata gjithë të akuzuarit hollësisht i ka njoftuar me të drejtat e tyre procedurale të parapara në dispozitën ligjore të nenit 246 paragraf 1 të KPP-së.

Gjithë të akuzuarit kanë deklaruar se i kanë kuptuar të drejtat e tyre, të akuzuarit [REDAKTUAR] i dhe [REDAKTUAR] deklaruan se mbrojtjen dëshirojnë ta paraqesin vetë, ndërsa të akuzuari [REDAKTUAR] dhe Afrim Hyseni deklaruan se dëshirojnë të mbrohen përmes mbrojtëseve, i akuzuari [REDAKTUAR] ka angazhuar për mbrojtës av. Gani Rexha, ndërsa i akuzuari [REDAKTUAR] për mbrojtës ka angazhuar av. Gazmen Ismajli dhe av. Elvir Imeri.

Në shqyrtimin fillestar në gjykatë aktakuzën e përfaqësoi prokurori i shtetit Jovo Radoviq, pas leximit të aktakuzës nga i njëjti, i akuzuari i parë [REDAKTUAR] në tërësi e ka pranuar fajësinë për veprat penale të cilat i vihen në barrë sipas aktakuzës, shprehu keqardhje për rastin që ka ndodhur i premtori gjykatës se në të ardhmen nuk do t'i përsëris veprimet e tilla.

Të akuzuarit [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] u deklaruan të pafajshëm për kryerjen e veprave penale për të cilat ata akuzohen sipas aktakuzës.

Pas pranimit të fajësisë nga i akuzuari [REDAKTUAR] gjykata e kërkoi mendimin nga prokurori i shtetit i cili me këtë rast i propozoj gjykatës që ta aprovojë këtë pranimi fajësie.

Pas pranimit të fajësisë nga i akuzuari [REDAKTUAR] dhe pas marrjes së mendimit nga prokurori i shtetit, gjyqtari i vetëm gjykues në bazë të dispozitës ligjore të nenit 248 paragraf 4 lidhur me paragraf 1 të KPP-së, ka marr vendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga ky i akuzuar lidhur me veprat penale të cila i vihet në barrë sipas kësaj aktakuzë nga se konsideroj se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare nga i pandehuri dhe se i njëjti i ka kuptuar pasojat e pranimit të fajësisë dhe ka vazhduar me shqiptimin e dënimit ndaj këtij të pandehurit duke ia shqiptuar dënimin si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Meqenëse i akuzuari [REDAKTUAR] u deklarua fajtor për veprat penale për të cilat ai akuzohet sipas aktakuzës ndërsa të akuzuarit tjerë në këtë qeshje penale [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] u deklaruan të pafajshëm për kryerjen e veprave penale për të cilat ata akuzohen sipas aktakuzës, gjykata duke u bazuar në dispozitën ligjore nga neni 36 të KPP-së, pas marrjes së mendimit edhe nga të gjitha palët tjera për hir të efikasitetit të procedurës ka marrë vendim me të cilin e ka veçuar procedurën penale për të akuzuarin [REDAKTUAR] dhe ka vazhduar me shqiptimin e dënimit ndaj të njëjtit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi për të akuzuarin [REDAKTUAR] gjykata e vërtetoi para së gjithash në bazë të pranimit të fajësisë nga i akuzuari

pranimi i cili ishte i vullnetshem dhe i mbështetur në të gjitha pikat e aktakuzës dhe nga provat tjera materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës siç ishin të gjitha shkresat policore sipas numrit të rastit 2014-BC-340, të dt. 04.04.2014, gastaj raportet policore të dt. 09.03.2014 dhe të dt.14.03.2014, nga raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes i dt.10.03.2014, pastaj nga deklaratimet e të dëmtuarve-dëshmitarëve [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] të dhëna në policinë e Kosovës dhe nga vështrimi në foto dokumentacionin dhe në të gjitha shkresat tjera të lëndës, me pa mëdyshje u vërtetua se i akuzuari [REDAKTUAR] e ka kryer veprën penale për të cilën ai akuzohet.

Gjykata pas vlerësimit të gjitha provave, gjeti se në veprimet e të akuzuarit [REDAKTUAR] kemi të bëjmë me veprën penale në vazhdim pasi që plotësohen dy nga kushtet e parapara në nenin 81 parag.1 pika 1.2 dhe 1.5 të KPRK-së, ngase në rastin konkret është i njëjtë objekti i veprës penale (pasuria e huaj) dhe dashja e njëjtë e kryerësit (përvetësimi të kundërligjshëm), andaj për këto arsye gjykata e beri ricalësimin e veprës penale në veprën penale Vjedhje e rëndë në vazhdim nga neni 327 parag.1 pika 1.1 të KPRK-së, lidhur me nenin 81 të KPRK-së, për të cilën veprën penale të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënimin si në dispozitivin e aktgjykimit

Duke u mbështetur në këto fakte dhe prova të cilat gjenden në shkresat e lëndës në veprimet e të akuzuarit [REDAKTUAR] përmbushen të gjitha elementet e veprës penale- Vjedhje e rëndë në vazhdim nga neni 327 parag.1 pika 1.1 të KPRK-së, lidhur me nenin 81 të KPRK-së, ngase i akuzuari me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vetë e ka marr pasurinë e huaj në atë mënyrë që me dt.09.03.2014 rreth orës 11;56 minuta në fshatin [REDAKTUAR] komuna e [REDAKTUAR] fillimisht në shtëpinë e të dëmtuarit [REDAKTUAR] përmes gilinderave të katit të parë të shtëpise ka depërtuar në ballkonin e katit të dytë duke përdorur forcën-duke shtyrë derën e ballkonit ka hyrë brenda në shtëpi dhe i ka marr një televizor "Panasonic", një kablo elektrike 15 metra, dy printerë të vjetër, një makine shkrimi e tipit të vjetër, një centrifug për bletë. Pastaj të njëjtën ditë me qëllim që me marrjen e sendeve të huaja të luajtshme vetit t'i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm nga oborri i shtëpisë së të dëmtuarit [REDAKTUAR] e cila gjendet në fshatin [REDAKTUAR] kom. Mitrovicës fillimisht me forcë ka thyer shtyllat e metalta, ka hjekur telin dhe ka depërtuar në oborrin e shtëpisë ku edhe ka marr tri bletë të cilat ishin të vendosura para ballkonit të shtëpisë, për çka gjykata të akuzuarin e shpalli penalisht përgjegjës dhe i'a shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata i pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara në nenin 73 të KPRK-së, e në rastin konkret për të akuzuarin [REDAKTUAR] si rrethanë lehtësuese gjeti faktin se i njëjti gjate shqyrtimit fillestar e pranoje në tersi fajësinë lidhur me aktakuzën e cila i vihej në barre me çka gjykatës i ndihmoje në mase të madhe në vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike, pastaj gjendjen e tij të dobët ekonomike, ndërsa rrethanë

rënduese e gjeti mënyrën e kryerjes së veprës penale, dhe se motivi i kryerjes së veprës penale ka qenë qëllimi i përfitimit në mënyrë të kundërligjshme.

Andaj gjykata duke u bazuar në rrethanat e cekura si më lart të akuzuarit [redacted] i shqiptojë dënim si në dispozitiv të aktgjykimit me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së, që të parandaloj kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata duke u bazuar në nenin 75 paragraf.1 nenparagraf.1.2 lidhur me nenin 76 paragraf.1 nenparagraf.1.3 të KPRK-së, me rastin e shqiptimit të dënimit për të akuzuarin [redacted] për veprën penale Vjedhje e rend ne vazhdim nga neni 327 paragraf.1 nenparagraf.1.1 të KPRK-së, vendosi që ndaj këtij të akuzuari ta zbutë dënimin ngase konstatoi se ekzistojnë rrethana posaçërisht lehtësuese të cilat tregojnë se qëllimi i dënimit mund të arrihet edhe me shqiptimin e dënimit me të butë, siç janë faktet se ky i pandehur e ka pranuar në tersi fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, pendimin për veprën penale të kryer, andaj gjykata duke u bazuar në të gjitha të cekurat si më lartë konstatoi faktin se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit.

Vendimin për cilësimin e veprës penale si vepër penale e kryer ne vazhdimësi gjykata e mori në bazë të dispozitës ligjore nga neni 81 paragraf.1 pika 1.2 dhe 1.5 të KPRK-së.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor, gjykata e mori në bazë të nenit 450 paragraf.2 nenparagraf.2.6 dhe nenin 453 paragraf.1 të KPP-së.

Vendimin mbi udhëzimin e të dëmtuarve në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike gjykata e mori sipas nenit 463 paragraf.1 dhe 2 të KPP-së. Nga si u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.346/2015, dt.29.05.2018

Procesmbajtësja
Albana Gashi

Gjyqtari i vetëm gjyqësor
Mentor Hajraj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate për gjykatën e Apelit në Prishtinë.

19.07.2018

[Signature]